



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 495 Prot.

Tiranë, më 08.05.2019

UDHËZIM

Nr. 03, datë 08.05.2019

PËR
PËR ZBATIMIN E NENIT 10, PIKA 3 TË RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT MBI KORRIGJIMIN E DOKUMENTEVE TË PLANEVE TË
PËRGJITHSHME VENDORE NË FUQI

Në mbështetje të nenit 28, të Ligjit Nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neneve 3, 9, 13, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenet 2 dhe 10 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”,

UDHËZOJ:

1. Procesi i Korrigjimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore përmban hapat, si më poshtë:
 - a. **Korrigjimi i rasteve të konstatuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashki**
 - ✓ DPKZHT pas identifikimit të rasteve problematike të përcaktimeve në dokumentin e PPV-së, harton një relacion shpjegues me konstatimet e detajuara për secilin rast. Relacioni duhet të përmbajë:
 - Bazën ligjore ku mbështetet korrigjimi i dokumentit të planifikimit;
 - Rastet e konstatuara problematike;
 - Njësinë/të strukturore që preken nga korrigjimi;
 - Ortofoto e territorit që preket nga korrigjimi;
 - Parashikimet aktuale të PPV-së për këtë/to njësi;
 - Korrigjimin e parashikimeve të PPV-së, sipas rasteve të konstatuara;
 - Argumentimin e rasteve.

- ✓ Kryetari i Bashkisë pas konfirmimit dërgon me shkresë zyrtare në AKPT dhe boton në RKPT, kërkesën për vlerësimin e rasteve të konstatuara, shoqëruar me Relacionin Shpjegues të hartuar nga DPKZHT.

b. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, vlerëson propozimet për korrigjim të dokumentit të PPV-së

- ✓ Grupi i punës në AKPT, shqyrton dhe vlerëson rastet e konstatuara, referuar Relacionit Shpjegues të hartuar nga DPKZHT;
- ✓ Grupi i punës në AKPT, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të rasteve harton Relacionin Shpjegues të saj;
- ✓ Nëse shihet e nevojshme AKPT jep sugjerime mbi korrigjimet e propozuara, për t'u reflektuar nga Bashkia;
- ✓ AKPT referuar Relacionit Shpjegues të hartuar nga grupi i punës, dakordësohet ose refuzon rastet për korrigjimet e propozuara;
- ✓ Konstatimet mbi refuzimin apo pranimin dhe Relacioni Shpjegues dërgohet me shkresë zyrtare pranë autoritetit vendor (Bashkia) dhe botohet në RKPT.

c. Miratimi në KKT i Vendimit për korrigjimin e dokumentit të PPV-së

- ✓ AKPT dërgon me shkresë zyrtare në Sekretariatit e Këshillit Kombëtar të Territorit (AZHT) kërkesën për miratimin e vendimit për korrigjimin e dokumentit të planifikimit, shoqëruar nga relacioni shpjegues. Bashkëlidhur shkresës dërgohen:
 - *Projekt-Vendimi për korrigjimin e dokumentit të PPV-së;*
 - *Relacioni Shpjegues mbi korrigjimin e dokumentit të PPV-së.*
- ✓ Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), përcjell në KKT, për miratim Projekt-Vendimin për korrigjimin e dokumentit të PPV-së.
- ✓ Vendimi për korrigjimin e dokumentit të PPV-së, hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

2. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat iniciojnë procesin e korrigjimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

3. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT, gjatë procesit të korrigjimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore.

DREJTORE E PËRGJITHSHME


Adelina GRECA